

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shpallen të pafajshëm për krime kundër njerëzimit, por liderët e UÇK-së dënohen nga Gjykata e Hagës me 81 vite burg
ADRESA	https://tpz.al/shpallen-te-pafajshem-per-krime-kunder-njerezimit-por-lideret-e-uck-se-de-nohen-nga-gjykata-e-hages-me-81-vite-burg-i333057
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 10:10:06 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 10:04:49 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	62456204b2480e7796a4f3517991605874a5fdadefd817046e0523b59d22d15c
TEKSTI	6e9d36928efa78bbb7fbff80f650572ec6253134741782a3a73addbb692ecab9
PAMJA	89189b8374963339d0d3c1058b62e1c12d828841b88b757fbfbfe8674e1e9f18

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	395be33da35891f19481ef54d5db4abb8e0f3fe1bf315a850921c1e94b6550dd
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	1f56947d1ce9865195ccff7ffa5c5fdb522467bfff0934ba4720654b865868030
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/395be33da35891f19481ef54d5db4abb8e0f3fe1bf315a850921c1e94b6550dd

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

12:04 Shpallen të pafajshëm për krime kundër njerëzimit, por liderët e UÇK-së dënohen nga Gjykata e Hagës me 81 vite burg • 12:02 Prishtinë/ Vendimi i Hagës, qytetarët sh

AKTUALITET, 16 SEPTEMBER 2026, 12:04

Shpallen të pafajshëm për krime kundër njerëzimit, por liderët e UÇK-së dënohen nga Gjykata e Hagës me 81 vite burg

tpz.al TPZ



Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë kanë shpallur aktgjykimin e shkallës së parë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Të katër janë shpallur fajtorë për një sërë krimesh lufte dhe janë dënuar me gjithsej 81 vite burgim.

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është dënuar me 25 vite burgim, ndërsa Kadri Veseli me 18 vite burgim.

Rexhep Selimi është dënuar me 13 vite burgim, ndërsa Jakup Krasniqi me 25 vite burgim.

Hashim Thaçi

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është shpallur fajtor dhe është dënuar me 25 vjet burgim nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, e njohur ndryshe si Gjykata Speciale.

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi është penalisht përgjegjës për krime lufte, thotë trupi gjyqës.

Trupi gjyqës ka shqiptuar dënime të veçanta për veprat për të cilat Hashim Thaçi është shpallur fajtor:

-Pika 3 – Arrestim dhe ndalim arbitrar: për 385 persona, 15 vjet burgim.

-Pika 5 – Trajtim mizor: i kryer ndaj së paku 49 personave, 4 vjet burgim.

-Pika 7 – Torturë: e kryer ndaj së paku 303 personave, 20 vjet burgim dhe

ide!

Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?

Nga Andi Bushati

Në Shqipërinë e sotme "revolucionin" ka emrin pjesëmarrje dhe alternativë

Nga Preç Zogaj

Teje e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose kliko këtu për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super

-Pika 9 – Vrasje e paligjshme: e kryer ndaj së paku 96 personave, 23 vjet burgim.

Megjithatë, trupi gjykues ka shqiptuar një dënim të njësuar prej 25 vjetësh burgim, në të cilin do të llogaritet edhe koha që Thaçi ka kaluar në paraburgim.

Në këtë proces, Thaçi përballej me akuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, përfshirë: përndjekje, burgosje, veprime çnjerëzore, torturë, vrasje të paligjshme dhe zhdukje me forcë

Vendimi i shpallur sot është aktgjykim i shkallës së parë dhe ndaj tij mund të ushtrohen mjetet juridike të parapara me ligj.

Jakup Krasniqi

Jakup Krasniqi dënohet 25 vite në total.

"Jakup Krasniqi, shpalleni fajtor për arrestim të paligjshëm si krim lufte, kryer kundër së paku 385 personave. Trajtim mizor si krim lufte, kryer kundër së paku 49 personave. Torturë si krim lufte, kryer kundër së paku 303 personave dhe vrasje të paligjshme si krim lufte kryer kundër 96 personave.

Shpalleni i pafajshëm për një numër krimesh luftesh, sepse nuk u vërtetuan. I pafajshëm për përndjekje, burgosje, akte çnjerëzore dhe zhdukje me forcë. Dënimi përcaktohet me dënim me vete për secilën vepër penale. Më pas dënimi i njehsuar.

15 vite burg për arrestim të paligjshëm, 4 vite për trajtim mizor, 20 vjet për torturë dhe 23 për vrasje të paligjshme. Denoheni me dënim të njehsuar mer 25 vite, ku llogaritet dhe koha e kaluar në paraburgim", u shpreh gjyqtari.

Kadri Veseli

Kadri Veseli është dënuar me 18 vjet burgim nga Dhomat e Specializuara në Hagë.

Trupi gjykues e shpalli Veselin fajtor për krime lufte, përfshirë ndalimin e paligjshëm ose arbitrar, trajtimin mizor, torturën dhe vrasjen e paligjshme.

Rexhep Selimi

Ndersa Dhomat e Specializuara në Hagë kanë dënuar Rexhep Selimin me 13 vjet burgim, pasi e shpallën fajtor për krime lufte.

Trupi gjykues arriti në përfundimin se Prokuroria e Specializuar provoi përtej dyshimit të arsyeshëm përgjegjësinë penale të Selimit për një pjesë të akuzave për krime lufte.

Njëkohësisht, gjykata e shpalli të pafajshëm për akuzat për krime kundër njerëzimit.

Selimi ndodhet në paraburgim në Hagë që prej nëntorit 2020 dhe gjatë gjithë procesit është deklaruar i pafajshëm për të gjitha akuzat.

[rëndë nga "Specialja", reagon Rama: Marre!](#)

[Speciale: Të paktën 303 persona u keqtrajtuuan nga anëtarë të UÇK-së](#)

AKTUALITET / 16 September 2026, 10:56

[Kryesuesi i Panelit të Trupit Gjykses në Hagë: Kjo çështje gjyqësore nuk ka të bëjë me legjitimitetin e UÇK-së, por vetëm me përgjegjësi personale](#)

AKTUALITET / 16 September 2026, 10:54

[Gjyqi në Hagë/ Rrëzohen akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit ndaj popullatës civile për krerët e UÇK-së](#)

AKTUALITET / 16 September 2026, 10:49

[Credins bank sjell Visa Infinite, kartën e parë metalike në Shqipëri!](#)
Artikull Promocional

AKTUALITET / 16 September 2026, 10:40

[Detaje/ Prej tre ditësh i arratisur, autoritetet vijojnë kërkimet për shqiptarin Alket Rizain: Po kryejmë kontrolle në të gjithë Greqinë](#)

AKTUALITET / 16 September 2026, 10:26

["Ruani qetësinë"/ Haga nis leximin e vendimit ndaj krerëve të UÇK, gjyqtari hap seancën: Po gjykojmë përgjegjësi individuale, jo luftën çlirimtare](#)

AKTUALITET / 16 September 2026, 10:21

[Konsultimet/ Rama mbërrin në Korçë për takimin mbi reformën territoriale, i pranishëm edhe djali i tij Greg Rama](#)

AKTUALITET / 16 September 2026, 10:09

Pronat/ Banesat pa dokumente pronësie, Kadastra zbret në terren në 23 fshatra të Himarës, publikohet kalendari me datat e evidentimit derë më derë

AKTUALITET / 16 September 2026, 09:56

Operacioni/ U kap duke transportuar 6 emigrantë sudanezë drejt Tiranës, arrestohet 23-vjeçari në Devoll

AKTUALITET / 16 September 2026, 09:38

Vendimi/ I akuzuar për trafik ndërkombëtar droge, Gjykata Supreme e Brazilit jep dritën jeshile për ekstradimin e Ervin Matës në Shqipëri

AKTUALITET / 16 September 2026, 09:25

Ankimimi i "Paketës së Maleve", Kushtetuesja e kalon çështjen për shqyrtim në seancë plenare! Kërkohet pezullim

AKTUALITET / 16 September 2026, 22:55

Rama udhëton më 20 shtator drejt SHBA-së, zbardhen detaje nga takimet që pritet të zhvillojë

AKTUALITET / 16 September 2026, 22:24

Mbyllet protesta e 108-të kundër qeverisë, qytetarët përfundojnë marshimin me thirrjen: Nesër më shumë!

AKTUALITET / 16 September 2026, 21:48

Kultivoi 18 kg drogë/ Arrestohet shqiptari në Vjenë, sekuestrohen kokainë, marihuanë dhe Crystal Meth

AKTUALITET / 16 September 2026, 21:40

"Jam çlirimtar"/ Nga thirrjet para kryeministrit të marshimi në rrugët e Tiranës, çfarë ndodhi në protestën e 108-të

AKTUALITET / 15 September 2026, 21:26

Kreu i Gjykatës së Lartë Sokol Sadushi pritet nga Mattarella në Romë/ Presidenti italian do të jetë në Tiranë për World Law Congress 2027

AKTUALITET / 15 September 2026, 21:12

"O hajdut, o hajdut..." - Protestuesit përballen me Taulant Ballën, ai largohet nga lokali (VIDEO)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.